

VENDIM
Nr. 253, datë 25.3.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ARABE TË
EGJIPTIT, PËR BASHKËPUNIMIN DOGANOR DHE NDIHMËN E NDËRSJELLË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit, për bashkëpunimin doganor dhe ndihmën e ndërsjellë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI BASHKËPUNIMIN DOGANOR
DHE NDIHMËN E NDËRSJELLË**

Qeveria e Republikës Arabe të Egjiptit dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me poshtë quhen “Palët Kontraktuese”,

nisur nga domosdoshmëria e zhvillimit të marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet të dyja vendeve,

duke synuar vendosjen e bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë ndërmjet të dy vendeve në fushën e kontrollit doganor dhe luftën kundër veprave me karakter doganor,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Termat që përdoren për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të thonë:

- Termi “Legjislacion doganor” do të thotë të gjitha dispozitat legislative dhe rregullatore të zbatuara nga administratat doganore të dyja Palëve Kontraktuese që rregullojnë importin, eksportin dhe transitin e mallrave, dhe vendosjen e tyre në një procedurë doganore, duke përfshirë masat e ndalimit, kufizimit, kontrollit, udhëzimet doganore dhe vendimet ministrore.

- Termi “Shërim doganor”: në Republikën Arabe të Egjiptit, Autoriteti Doganor Egjiptian; në Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

- Termi “Vepra penale me karakter doganor” do të thotë të gjitha veprat penale sipas legjislacionit doganor ose një tentative për kryerjen e një vepre penale.

- Termi “Person” do të thotë çdo subjekt fizik dhe juridik.

- Termi “Lëndë narkotike” do të thotë substancat e përfshira në nomenklaturën e Konventës Unike të Lëndëve Narkotike, të vitit 1961, me ndryshimet e mëvonshme.

- Termi “Substanca Psikotrope” do të thotë substancat e përfshira në nomenklaturën e Konventës së Substancave Psikotrope, të vitit 1971, me ndryshimet e mëvonshme.

- Termi “Detyrimet dhe taksat doganore” do të thotë detyrimet doganore dhe të gjitha detyrimet,

taksat, tarifat ose pagesat e tjera që arkëtohen për ose në lidhje me importin ose eksportin e mallrave, por duke mos përfshirë tarifën dhe detyrimet që janë të kufizuara në shumë, në koston përkatëse të shërbimeve të dhëna.

- Termi “Dorëzim i kontrolluar” është procedura e ndërmarrë në territoret doganore të Palëve Kontraktuese për importimin dhe eksportimin e dërgesave të paligjshme ose ato që pritet të përmbajnë lëndë narkotike dhe substanca psikotrope ose substancat e zëvendësuara dhe çdo mall të transportuar në mënyrë të paligjshme nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e autoriteteve të tyre kompetente me qëllim identifikimin e personave të përfshirë në trafikimin e paligjshëm të këtyre mallrave.

- Termi “Autoriteti kërkuar” është autoriteti doganor kompetent i një pale që bën një kërkesë për ndihmë në çështjet doganore në pajtim me këtë Marrëveshje.

- Termi “Autoriteti i kërkuar” është autoriteti doganor i një pale që merr një kërkesë për ndihmë në çështjet doganore.

- Termi “Informacion” është çdo e dhënë ose dokument, ose raport, apo dokument elektronik apo kopje nga dokumentet origjinale.

Neni 2

Sfera e kontrollit

Për të gjitha qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese marrin të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar kontrollin doganor të transportimit të mallrave, pasagjerëve dhe dërgesave postare, dhe të zbatojnë metodat e këtij kontrolli, si dhe për qëllimin e parandalimit të importit, eksportit, transitit të mallrave, mjeteve të transportit, pasagjerëve, dërgesave postare, vlerave valutore të paligjshme që do të dëmtonin interesat ekonomike dhe fushat e tjera në Republikën Arabe të Egjiptit dhe Republikën e Shqipërisë, në pajtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm të të dyjave dhe pa cenuar detyrimet e Palëve Kontraktuese sipas një marrëveshjeje tjetër ndërkombëtare në të cilën ato janë Palë Kontraktuese.

Neni 3

Sferat e ndihmës

Me kërkesën e autoritetit doganor të një prej Palëve Kontraktuese, mallrat, mjetet e transportit, vlerat valutore dhe artikuj të tjerë të importuar në territorin e një prej Palëve Kontraktuese dhe të refuzuara nga një prej autoriteteve të kontrollit të Palës Kontraktuese, rieksporthen në Palën tjetër Kontraktuese, duke treguar shkaqet e refuzimit në dokumentet përkatëse.

Neni 4

Objekti i ndihmës së ndërsjellë

Në lidhje me të gjitha mallrat e importuara në mënyrë të paligjshme nga territori i një pale në territorin e palës tjetër, zbatohet legjislacioni i brendshëm doganor i territorit ku gjenden mallrat.

Palët Kontraktuese, në pajtim me legjislacionin dhe dispozitat e vendeve të tyre përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje, bashkëpunojnë me qëllim që të parandalojnë dhe të hetojnë kontrabandën dhe veprat penale me karakter doganor, si dhe trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancat psikotrope. Ky informacion, me shkrim apo me gojë, konsiderohet konfidencial.

Neni 5

Konfidencialiteti i informacionit

a) Dokumentet dhe informacioni tjetër i marrë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje mund të përdoret nga

Pala Kontraktuese marrëse vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe vetëm nga autoritetet kompetente, duke përfshirë përdorimin e tyre në procedimet gjyqësore apo administrative. Këto dokumente dhe informacione të tjera mund të përdoren nga Pala Kontraktuese marrëse për qëllime të tjera vetëm me pëlqimin e Palës Kontraktuese dhënëse.

b) Me kërkesë të Palës Kontraktuese dhënëse, dokumentet dhe informacioni tjetër i dhënë Palës tjetër Kontraktuese, sipas kësaj Marrëveshjeje, konsiderohet si konfidencial nga Pala Kontraktuese marrëse.

c) Dokumenteve dhe informacionit tjetër të dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje i jepet e njëjta shkallë konfidencialiteti që zbaton ky vend.

d) Në rastet kur shkëmbehen të dhëna personale sipas kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese u japin të njëjtën mbrojtje që zbatohet në Palën Kontraktuese që i jep ato, në pajtim me legjislacionin e brendshëm brenda territorit të shtetit të saj.

Neni 6

Ekspertët dhe dëshmitarët

1. Administrata doganore e një Pale Kontraktuese mund të autorizojë nëpunësit e saj me kërkesë të administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese të paraqiten si ekspertë ose si dëshmitarë në procedime gjyqësore ose administrative në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Marrëveshje në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe të paraqesë dosje, dokumente ose kopje të vërtetuara të tyre, që mund të nevojiten në këto procedime.

Kërkesa për paraqitje duhet të tregojë se para cilit autoritet gjyqësor ose administrativ duhet të paraqitet nëpunësi, për cilat çështje dhe në bazë të cilës cilësie apo kualifikimi do të pyetet nëpunësi.

2 Administrata kërkuuese është e detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e plotë të sigurisë personale të nëpunësit gjatë qëndrimit në territorin e saj dhe konfidencialitetin e dëshmisë, sipas paragrafit (1) të këtij neni. Transporti, akomodimi dhe dietat ditore të këtyre nëpunësve mbulohen nga administrata kërkuuese.

3. Kërkesa për paraqitjen e nëpunësve të doganave si ekspertë dhe dëshmitarë bëhen në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palëve Kontraktuese.

Neni 7

Mbikëqyrja e njerëzve, mallrave, mjeteve të transportit, vendndodhja

Palët, me iniciativë të tyre dhe me kërkesë të palës tjetër, u paraqesin njëra-tjetrës informacion për sa më poshtë:

- a) Personat që njihen ose dyshohen të përfshirë në kontrabandë dhe trafik të paligjshëm;
- b) Mjetet e transportit, mallrat dhe dërgesat postare që përdoren për kontrabandën e mallrave;
- c) Faktet që tregojnë kontrabandën dhe trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike nga territori i palës në territorin tjetër;
- d) Metodot e proceseve të kontrabandës dhe mënyrat e zbulimit të tyre;
- e) Mallrat që dihen ose dyshohen të jenë objekt i veprave penale me karakter doganor.

Neni 8

Kërkesa për ndihmë

Kërkesat për ndihmë sipas kësaj Marrëveshjeje paraqiten me shkrim dhe shoqërohen nga dokumentet të nevojshme për ekzekutimin e saj.

Kërkesat me shkrim përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- Emrin e shërbimit doganor që paraqet kërkesën;
- Objektin dhe shkakun e kërkesës;
- Emrat dhe adresat e personave që janë objekt hetimi, nëse dihen;

- Një përshkrim i shkurtër i rastit në shqyrtim dhe elementet ligjore përkatëse të përfshirë;
- Masa e kërkuar;
- Një përmbledhje të fakteve përkatëse dhe të hetimeve të kryera.

Korrespondencat e shkëmbyera sipas kësaj Marrëveshjeje zhvillohen në gjuhët zyrtare të palëve me përkthimin e tyre në gjuhën angleze. Nëse një kërkesë nuk përmbush kërkesat formale, autoriteti i kërkuar mund të kërkojë korrigjimin ose plotësimin; ose marrjen e masave paraprake.

Neni 9

Komunikimi i informacionit

Autoriteti i kërkuar ia komunikon rezultatet e arritura autoritetit kërkuar në formën e informacionit dhe nëse është e nevojshme gojarisht.

Dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1 mund të zëvendësohen me informacion kompjuterik të prodhuar në çdo formë për të njëjtin qëllim dhe shoqërohet me informacionin e nevojshëm për interpretimin dhe përdorimin e informacionit të kompjuterizuar.

Neni 10

Bashkëpunimi në luftën kundër eksportimit/importimit të paligjshëm të pasurisë kulturore

Palët Kontaktuese, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe sipas kësaj Marrëveshjeje, bashkëpunojnë në luftën kundër eksportit/importit të paligjshëm të pronës kulturore. Autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese u kthejnë njëra-tjetrës monumentet, sendet antike dhe çdo pronë tjetër kulturore, të cilat janë importuar në mënyrë të paligjshme nga territori i një Pale Kontraktuese në territorin e tjetrës.

Neni 11

Përjashtimi nga detyrimi për dhënien e ndihmës

a) Në rastet kur Pala Kontraktuese e kërkuar është e mendimit që dhënia e përgjigjes së kërkesës mund të ishte në dëm të sovranitetit, sigurisë, rendit publik ose sfera të tjera thelbësore të interesave kombëtare, ajo mund të refuzojë dhënien e ndihmës ose mund të bjerë dakord për ta dhënë atë sipas kushteve të caktuara.

b) Nëse refuzohet ndihma, administratës kërkuese i jepen pa vonesë me shkrim shkaqet për refuzimin.

Neni 12

Shpenzimet e ndihmës

Palët Kontraktuese nuk pretendojnë asnjë rimbursim të shpenzimeve të shkaktuara gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Shpenzimet dhe tarifat për dëshmitarët, ekspertët dhe përkthyesit, të cilët nuk janë nëpunës qeveritarë, mbulohen nga pala kërkuese.

Nëse zbatimi i kërkesës sjell ose mund të sjellë si pasojë shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme ose të konsiderueshme, autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese konsultohen me njëra-tjetrën për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilëve do të zbatohet kërkesa, si dhe mënyrën se si do të mbulohen këto shpenzime.

Neni 13

Zbatimi i Marrëveshjes

Çështjet e diskutueshme në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet bisedimeve ndërmjet shërbimeve doganore të palëve.

Kjo Marrëveshje ndryshohet nëpërmjet marrëveshjes reciproke të palëve dhe ky ndryshim hyn në fuqi

në pajtim me procedurat e përmendura në nenin 19 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

Palët t'u japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me legjislacionet e tyre përkatëse në fuqi, në lidhje me çështjet doganore.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e njoftimit të fundit të përfundimit të procedurave ligjore të zbatuara në të dyja vendet. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe, përveç kur njëra prej Palëve njofton tjetrën, me shkrim, në lidhje me synimin e saj për të pushuar zbatimin e Marrëveshjes gjashtë muajve para datës së pushimit.

Bërë në Kajro, më 1 shkurt 2015, në dy kopje origjinale, në gjuhët arabe, shqipe dhe angleze, ku të gjithatekstet janë njëloj të vlefshme. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në anglisht mbizotëron.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Ditmir Bushati

Ministër i Punëve të Jashtme

Për Qeverinë e Republikës së Egjiptit

Sameh Shoukry

Ministër i Punëve të Jashtme